



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 495

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 406 NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" NË BASHKINË HIMARË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që i përket:

KËRKUES: Partia Socialiste e Shqipërisë

OBJEKTI: Kërkohet heqja e materialeve propagandistike të vendosura nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", në kundërshtim me kuadrin ligjor në Bashkinë Himarë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", e pika 2, neni 79, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.3.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" ka depozituar denoncimin regjistruar me nr. 406 ID, datë 10.05.2023, mbi heqjen e materialeve propagandistike të vendosur në kundërshtim me kuadrin ligjor në Bashkinë Himarë nga Koalicioni Bashkë Fitojmë".

Data: 11.5.2023 Nr: 495
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 406 nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për afishimin e materialeve propagandistike të Koalicionit "Bashkë Fitojmë" në Bashkinë Himarë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Sipas subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" pretendohet se, "Në Njësine Administrative Lukovë në datën 5.5.2023, si dhe në Njësine Administrative Himarë në datë 9.5.2023 janë vendosur banera me përmasa afërsisht 6*2 m nga Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në fasada banimi, si dhe nuk përmbajnë shënimin "Prodhua nën përgjegjësinë ligjore të..." (vijon emri i subjektit zgjedhor)".

Pala kërkuese kërkon marrjen e masave urgjente për heqjen e banerave/posterave të vendosura në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Në përgjigje të këtij denoncimi, KQZ filloi hetimin administrativ përkatës duke kërkuar informacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka kërkuar nga monitoruesi i caktuar nga KQZ për monitorimin e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion në lidhje me afishimin e këtyre materialeve propagandistike.

Nga informacioni i dërguar nga monitoruesi rezultoi se, materialet propagandistike janë vendosur në Njësine Administrative Lukovë dhe Himarë në fasadat e godinave të banimit dhe nuk përmbajnë shënimin "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ..." (vijon emri i subjektit zgjedhor)".

Raporti i monitoruesit është i shoqëruar me foto ku konstaton vendosjen e këtyre materialeve propagandistike.

Në datë 3.5.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi vendimin nr. 424, "Për heqjen e materialeve propagandistike që nuk përmbajnë shënimin "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ..." (vijon emri i subjektit zgjedhor)", nëpërmjet të cilit ngarkohet Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake për heqjen e të gjitha materialeve propagandistike të cilat nuk përmbajnë këtë shënim. Ky vendim u adresohet të gjithë subjekteve zgjedhore që nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor, dhe ngarkon Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit për zbatimin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 424, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u është përcjellë të gjitha bashkive si dhe Policisë së Shtetit me shkresat nr. 4640 Prot. dhe nr. 4651 Prot., datë 4.5.2023.

Pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve nga denoncuesi, si dhe raportit të monitorimit vlerësojmë se materialet propagandistike janë vendosur në kundërshtim të pikës 3, të nenit 79, të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 3, pika 2 të udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n", e pika 2, nenin 79, pika 3, të Kodi Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 6, datë 23.3.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

Data: 11.5.2023 Nr: 495
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 406 nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për afishimin e materialeve propagandistike të Koalicionit "Bashkë Fitojmë" në Bashkinë Himarë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

VE ND OS:

1. Urdhërimin e subjektit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, Policinë e Shtetit dhe Policinë Bashkiake Himarë për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike në Njësinë Administrative Lukovë dhe Njësinë Administrative Himarë.
2. Ngarkohen subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Himarë për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi.
3. Ky vendim t’u njoftohet menjëherë subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Himarë nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI